



Pranuar / Dorezuar Punimje/Produkte Received/Delivery	05.02.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	525/2021		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.03/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.03/2021 të datës 05.01.2021, të parashtruar nga ankuesja me adresë Rruga "Onufri" numër 8, Komuna e Pejës, kundër organit të punësimit Komuna e Pejës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 03.02.2021, mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.03/2021 të datës 05.01.2021, të parashtruar nga ankuesja.

### A r s y e t i m

Ankuesja nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 05.01.2021 me numër protolli 14/2021 e regjistruar me numër A.nr.03/2021, kundër Aktvendimin me numër Nr.01-112/01-0117966/20 të datës 09.12.2020, të Kryetarit të Komunës së Pejës, për zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Teatrit Profesional "Istref Begolli"

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.01.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Pejës. Ndërsa Këshilli më datë 25.01.2021 ka pranua nga Komuna e Pejës, përgjigjen në kërkesë me numër protokolli: 282/2021, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

*Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokolli 14/2021 të datës 05.01.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Letërnjoftimin e ankueses; Aktvendimin e Kryetarit të Komunës së Pejës të datës 09.12.2020 me numër Nr.01-112/01-0117966/20; Procesverbalin e Këshillit të Teatrit Istref

Begolli të datës 08.12.2020; Ankesën e parashtruar nga ankuesja në komunën e Pejës të datës 05.01.2021; Formularin për paraqitje të ankesës në Komunën e Pejës të datës 05.01.2021; Përgjigjen në kërkesë e komunës së Pejës e datës 18.01.2021; Kopjen e konkursit të datës 16.11.2020; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Pejës i datës 07.10.2020; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Pejës i datës 19.11.2020; Procesverbalin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të datës 02.12.2020; Njoftimet për intervistë të datës 04.12.2020 të dërguara përmes e-mailit të kandidatët; Procesverbalin e Këshillit Drejtues të Teatrit Istref Begolli i datës 02.12.2020; Njoftimin për përzgjedhjen e Drejtorit të Teatrit 'Istref Begolli' të datës 01.12.2020 dërguar nëpërmjet e-mailit kandidatëve pjesëmarrës; Kërkesën për punësim të kandidatës të datës 30.11.2020 me numër 05/112/01 me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesën për punësim të kandidatës Krenare Luta-Radoniqi të datës 25.11.2020 me numër 05/112/01 me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesën për punësim të kandidatit Arbër Belegu të datës 27.11.2020 me numër 05/112/01 me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesën për punësim të kandidatës të datës 27.11.2020 me numër 05/112/01 me dokumentacionin e bashkangjitur; Kërkesën për punësim e ankueses të datës 30.11.2020 me numër 05/112/01 me dokumentacionin e bashkangjitur; Përgjigjen në kërkesë të dërguar nga Komuna e Pejës me datë 25.01.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 12.01.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë është jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.03/2021 të datës 05.01.2021, të parashtruar nga ankuesja  
*sepse:*

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se Komuna e Pejës me datë 16.11.2020, ka publikuar konkursin për përzgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Teatrit Profesional "Istref Begolli", në Pejë e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja Hateme Bytyqi. Kryetari i Komunës së Pejës përmes Aktvendimit numër Nr.01-112/01-0117966/20 të datës 09.12.2020, ka miratuar Rekomandimin e Këshillit Drejtues të Teatrit "Istref Begolli", për përzgjedhjen e Krenare Luta-Radoniqi për Drejtor të Përgjithshëm të Teatrit Profesional "Istref Begolli" në Pejë. E pakënaqur me këtë aktvendim, ankuesja ka parashtruar ankesë me datë 05.01.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit për pozitën "Drejtor i Përgjithshëm të Teatrit Publik-Istref Begolli" ankueses i janë manipuluar pikët e rezultatit nga Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 2 paragrafin 4 i cili ka përcaktuar se: *Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike*, si dhe nenin 3 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.04/106 për Teatrot që përcakton se Teatri është - institucion kulturor publik ose privat që merret me përgatitjen, organizimin dhe realizimin e shfaqjeve teatrore dhe shfaqjeve tjera skenike, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Teatrit hyn në kategorinë e nëpunësit të shërbimit publik.

Po ashtu Kolegji ka analizuar edhe dispozitat e nenit 64 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sipas të cilave dispozita marrëdhënia e punës lidhur me nëpunësit e shërbimit publikë rregullohet me Ligj të Punës, respektivisht kanë përcaktuar se: *Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punësimit për nëpunësin e Shërbimit Publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës. 2. Kjo pjesë e Ligjit përcakton rregullat për procedurën e konkurrimit, vlerësimin e punës, disiplinën e*



nëpunësit të Shërbimit Publik, si dhe procedurën e ndërprerjes të marrëdhënies së punës në rastet e vlerësimit "jo kënaqshëm" dhe shkeljeve disiplinore. 3. Një ligj i veçantë mund të parashikojë rregulla të ndryshme me këtë Ligj. Rregullimi me ligj të veçantë mund të bëhet vetëm në përputhje me parimet e përgjithshme të pranimit dhe menaxhimit të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji. Andaj, meqenëse ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil, rrjedhë së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.03/2021 të datës 05.01.2021 të parashtruar nga ankuesja

Bazuar nënin 6 paragrafi 1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat për nëpunësit civil dhe kandidatet për pranim në Shërbimin Civil, të përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Andaj, pas konstatimit se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, Kolegji udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nënin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.*


Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.03/2021

**Flakron Gashi**



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj-Demi**



Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

